

VENDIM
Nr. 66, datë 26.3.2018

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJT JANAR DHE
SHKURT 2018**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajt janar dhe shkurt 2018,”

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me anë të shkresës nr. 875/2 prot., datë 20.2.2018 (protokolluar në ERE, me nr. 72/2, datë 22.2.2018), dërgoi në ERE aplikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar dhe muajin shkurt 2018.

- OSHEE sh.a. e ka paraqitur këtë aplikim/ informacion mbi llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në 35 kV, të cilët ndodhen në kushtet e furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar dhe shkurt 2018, në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”.

- Në mbështetje të nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit bazohet në formulën e mëposhtme:

$$\text{ÇFMFt} = \text{KDFPt} + \text{CBEt} + \text{TRrTSHt}$$

ose:

$$\text{ÇFMFt} = \text{CBEt} + 10\% \text{ CBEt} + \text{TRrTSHt}$$

- Të dhënat e paraqitura nga OSHEE sh.a. në këtë aplikim u krahasuan me raportimet periodike të OSHEE sh.a., mbi blerjen e energjisë në treg të parregulluar për muajt respektivë, të dërguara në ERE.

- Sa më sipër, në zbatim të pikës 2, të nenit 7 të metodologjisë përkatëse, çmimi maksimal i blerjes së energjisë në treg të parregulluar për muajin janar 2018 rezultoi 64.00 euro/MWh dhe për muajin shkurt 2018 rezultoi 44.97 euro/ MWh.

- Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në ditën kur është mbyllur procedura e blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar për sistemin e shpërndarjes për muajin janar 2018 rezultoi 132.88 lekë/euro dhe për muajin shkurt 2018 rezultoi 133.48 lekë/ euro.

- ERE, në datën 2.3.2018, organizoi një seancë dëgjimore, me shoqërinë OSHEE sh.a. në lidhje me përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, ku u kërkuar informacion në lidhje me kostot e furnizimit të energjisë elektrike nga ky furnizues, si dhe u la detyrë që OSHEE sh.a. të kryejë një analizë specifike mbi kostot e FMF-së të cilën në periudhën në vazhdim duhet ta paraqesë pranë ERE-s. Në vijim të sa më sipër ERE mundet të kryejë llogaritjet e saj për të përcaktuar nëse marzhi i furnizimit prej 10% i kostos së blerjes së energjisë elektrike, përcaktuar në metodologjinë përkatëse, i mbulon apo jo kostot e furnizimit.

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 4396 prot., datë 8.3.2018, paraqiti në ERE informacion mbi kostot e furnizimit të shkaktuara gjatë muajve janar dhe shkurt 2018, të cilat mesatarisht arrijnë në 10% të kostos së blerjes së energjisë. Sipas OSHEE sh.a. norma mesatare prej 10% është brenda përcaktimeve të vendosura dhe në pikën 4, të nenit 6 të metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë

elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Kostot e furnizimit me energji elektrike janë llogaritur duke u bazuar në nenet 6 dhe 7 të metodologjisë në fuqi dhe rezultojnë 0.85 lek/ kWh për muajin janar 2018 dhe 0.60 lek/kWh për muajin shkurt 2018.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 210, datë 28.12.2017 “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018” është 0.75 lekë/ kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 211, datë 28.12.2017 “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018” është 1.5 lekë/kWh.

- OSHEE, me gjithë komunikimet e vazhdueshme të zhvilluara në kuadër të procesit të nisur mbi miratimin e çmimit të shitjes për klientët e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për periudhën janar dhe shkurt 2018, nuk ka mundur të dokumentojë koston e disbalancave për njësi të energjisë së furnizuar në rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për muajt janar–shkurt 2018.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, prej 11.6 (njëmbëdhjetë pikë gjashtë) lekë/kWh për muajin janar 2018 dhe 9.5 (nëntë pikë pesë) lekë/kWh për muajin shkurt 2018.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti